

**ENKELEJDA ALITE**

**NIPT L01606037A**

**Adresa: Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**

**Mob. +355 (0)67 2005022**

**e-mail: enkealite@yahoo.com;**

**Tiranë, më 26.08.2024**

**Lënda: Informacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2023 për Partinë e Reformave Demokratike Shqiptare**

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve  
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) nr.65, datë 28.06.2024, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2023 për 11 (njëmbëdhjetë) Parti Politike, midis të cilave ishte dhe Partia e Reformave Demokratike Shqiptare.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 06.08.2024, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me Partinë e Reformave Demokratike Shqiptare për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me poste të letrave me kthim përgjigje, në adresën e selisë së partisë vënë në dispozicion nga KQZ-ja.


Ne komunikuar menjëherë me kryetarin e Partisë Z.Krenar Rryci, i cili na deklaroi se gjatë vitit 2023 Partia nuk ka pasur aktivitet dhe për rrjedhojë nuk ka fonde të përfituara dhe të shpenzuara gjatë këtij viti.

Për rrjedhojë ne nuk mundëm të kryenim auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2023 për këtë parti.

Bashkangjitur do të gjeni deklaratën e firmosur nga kryetari i Partisë se Reformave Demokratike Shqiptare Z.Krenar Rryci.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

**Enkelejda Alite**  
**Auditues Ligjor**





Tiranë, më 14.08.2024

## DEKLARATË

Për: Zj. Enkelejda Alite  
Auditues Ligjor

Kjo deklaratë jepet në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion në lidhje me kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2023, nga Partia Reformave Demokratike Shqiptare, sipas Vendimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) nr.65, datë 28.06.2024.

Lidhur me kërkesën dhe informacionin e kërkuar nga ana juaj, unë, kryetar i kësaj partie, deklaroj me përgjegjësi të plotë se Partia Reformave Demokratike Shqiptare gjatë periudhes 01 Janar-31 Dhjetor 2023:

- Nuk ka pasur të ardhura nga asnjë burim financiar dhe material, si kuotat e anëtarësisë, fonde publike duke përfshirë dhe ndihmën financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit të miratuar me ligj nga Kuvendi, fondet jopublike të cilat janë dhurimet financiare, dhurimet në natyrë, shërbimet, sponsorizimet, kreditë apo garancitë e ndryshme, si dhe çdo transaksion tjetër financiar.
- Nuk ka pasur burime financiare dhe materiale të trashëguara nga viti 2022.
- Nuk ka realizuar blerje mallrash dhe shërbimesh për llogari të partisë nga operatorë tregtarë dhe individ dhe nuk kemi berë pagesa ndaj tyre.
- Nuk ka pasur personel të punësuar dhe për rrjedhim shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore.
- Nuk ka kontrata për ambiente me qera apo huapërdorje.
- Nuk ka të hapur asnjë llogari bankare në bankat e nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.

Në kushtet e mungesës së transaksioneve ekonomike dhe financiare kemi deklaruar me 0 (zero) raportimin financiar që kërkohet nga KQZ-ja apo nga institucione të tjera shtetërore për vitin 2023.

Konfirmoj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë dokument.

Për Partinë e Reformave Demokratike Shqiptare

Kryetari





1. PËR T'U PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMËRIMIT

Objekti ..... Nr. .... datë..... Lekë .....

Është pranuar në zyrën ..... në drejtim të zotit  
**PARTIA REFORMAVE DEMOKRATIKE**  
**SHQIPTARE**  
Rr. Muhammed Ghollesha ish-shkollëgjytorëve  
"8 Nëntori", Kati 3, Zyrë Nr. 30,

2. PËR T'U PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT

Objekti i sipërtreguar është ..... **25.8.2014** ..... Dorëzuar  
me ..... **25.8.14** .....

Emri mbijemri i marrësit të objektit ..... Emri mbijemri i shpërndarësit

SHËNIME TË VEÇANTA ..... Vula datare e zyrës .....  
Dorëzuese të objektit ..... **S**



Nr: 1001  
DEFTESE 06/08/2024 11:33:17

**PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE**

Objekti Letra Leter  
KOD-BAR RR645090104AA  
Derguesi ENKELEJDA ALITE  
Marresi PARTIA E REFORMAVE DEMOKRATIKE SHQIPTARE

Vend Mberrija TIRANA

Pesha 10 gr

LM RR645253575AA

Sherblme te vecanta 50  
LM ne postim 50

Tarifa Shtese 50

Tarifa Postare 70

Tarifa Totale 120

Nenshkrimi: Marjola Odobashi

ë, më 06.08.2024

**Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të auditimit ligjor**

**Për: Partia Reformave Demokratike Shqiptare**  
**Adresa e selisë: Rr.Muhamed Gjollësja, ish shtypshkronja "8 Nentori", kati3, zyra nr.30,Tiranë**

Me vendimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.65, datë 28.06.2024 , jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara nga Partia Reformave Demokratike Shqiptare gjatë vitit kalendarik 2023, të deklaruara në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera financiare dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

Sipas kontratës nr.2245 prot. datë 29.07.2024, me palën angazhuese KQZ-në, objekti i misionit të auditimit është: *"Kryerja e auditimit të detyrueshëm të fondeve të përfuara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2023, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfuara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjatë vitit kalendarik pararendës, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre". Afati kufi i përfundimit të procesit të auditimit është data 29.08.2024.*

Për kryerjen me sukses të misionit, brenda kohës së përcaktuar në kontratë, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit që merret me shërbimin kontabël për të na bërë të disponueshëm dokumentacionin kontabël,regjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Përgjigjen drejtojeni në adresën në krye të shkresës.

Faleminderit!

**Enkelejda Alite**  
**Auditues Ligjor**

